



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2024:184036

Datë: 08.08.2024

Numri i dokumentit: 06030877

2024:216933

NE EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ-DEGA KAÇANIK, Departamenti I Pergjithshem-Divizioni Penal, gjyqtarja Zajrete Muhaxheri si gjyqtare e vetme gjykuese, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Indira Beqa, në lëndën penale kundër të pandehurit M. K. nga Hani i Elezit, për veprën penale, Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par 1 nënpar.1.4 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP.II.nr.970/24 të datës 02.08.2024, me propozim për dhënien e urdhrin ndëshkimor, me dt.07.08.2024 merr këtë,

AKTGJYKIM

Pranohet kërkesa e Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP.II.nr.970/24 e datës 02.08.2024, me propozim për dhënien e urdhrin ndëshkimor dhe gjykata jep këtë,

URDHËR NDËSHKIMOR

I pandehuri M.K nga Hani i Elezit, i lindur më datë ... nga i ati F... dhe e ëma B..., e gjinisë K..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar, ka të kryer shkollën e mesme, me nr.personal: ...

E s h t ë f a j t o r

Sepse me datë më 13 qershor 2024, rreth orës 19:50h, në Hani Elezit, saktësisht në rrugën "...", në parking, me dashje i shkakton lëndime të lehta trupore të dëmtuarit J. Kalisi, në atë mënyrë që pasi të njëjtit takohen rastësisht, i afrohet të dëmtuarit dhe pas një mosmarrëveshje që kishin lidhur me një borxh dhe një mjet pune – brusalicë, i njëjti fillon ta godasë të dëmtuarin me grushte në kokë, me ç' rast i shkaktojnë lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin,

Me këtë veprim, i pandehuri ka kryer veprën penale, Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 1 nënpar.1.4 të KPRK-së.

Prandaj gjykata ne baze te nenit 2,38,81,82 të KPRK-se, dhe nenit 495 te KPP-se ,

VËREJTJE GJYQËSORE

Me të cilën të pandehurit i bëhet me dije se ka kryer veprën penale të dënueshme, dhe poqëse I njëjti sërish kryen veprën të tillë, gjykata do t'i shqiptojë sanksion penal më të rreptë.

Detyrohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor, të paguajë pranë kësaj gjykate, shumën prej 30.00€, ndërsa për Fondin për Kompensimin e Viktimave të Krimit shumën prej 20.00€, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

I dëmtuari J.K. nga Hani Elezit, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore ne Ferizaj me aktakuzën PP.II.nr.970/24 të datës 02.08.2024, e akuzoi të pandehurin M. K. nga Hani i Elezit, për veprën penale, Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 1 nënpar.1.4 të KPRK-së.

Aktakuzës i ka bashkangjitur Kërkesën me numër dhe datë të njëjtë me të cilën ka propozuar që ndaj te pandehurit të ipet Urdhëri Ndëshkimor dhe t' i shqiptohet Vërejtje Gjyqësore.

Gjykata vlerësoi propozimin e Prokurorit Shtetit dhe pasi konstatoi se te dhënat e ofruara ne kërkesë paraqesin bazë te mjaftueshme, vendosi që të jep Urdhërin ndëshkimor.

Me rastin e shqyrtimit paraprak te çështjes, gjykata gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 493 të KPP-së dhe konform nenit 495 par.1 te KPP-së vendosi që të pranojë kërkesën për dhënien e urdhërit ndëshkimor.

Gjykata gjeti se provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës dhe atë: raporti i oficerit me nr.2024-HE-37 i dt.13.06.2024, deklarata e të dyshuarit e dhënë në Stacionin Policor në Hani Elezit me dt.13.06.2024,procesverbali i marrjes në pyetje për të dëmtuarin në Stacionin Policor Hani Elezit i dt.14.06.2024, Raporti mjekësor nga QKMF në Hani Elezit, me nr.6398 i dt.13.06.2024 në emër të J. K., akt ekspertimi mjeko ligjor i punuar nga eksperti mjeko ligjor i dr. B. C. me nr të ref. 236/24 i dt.24.07.2024, procesverbali i marrjes në pyetje të pandehurit M. K. në Prokurorinë Themelore në Ferizaj me dt.18.07.2024, janë prova të besueshme me të cilat vërtetohet se i pandehuri e ka kryer veprën penale për të cilën është bërë kërkesa për lëshimin e urdhrit ndëshkimor.

Duke patur parasysh të lartëcekurat, gjykata vendosi që të pranojë kërkesën për dhënien e urdhërit ndëshkimor, me propozimin për dhënien e vërejtjes gjyqësore, ashtu siq është propozuar në aktakuzë, duke patur parasysh se i pandehuri bazuar në evidencën penale të gjykatës nuk është përsëritës i veprave penale të tilla apo të ngjashme si dhe duke patur parasysh faktin se i pandehuri, bazuar në deklarin e tij të dhënë në procedurën hetimore, përveq që e ka pranuar fajësinë, njëherit ka shprehur pendesë për veprimin e tij dhe ka premtuar se veprime të tilla nuk do të përsërisë në të ardhmen. Gjykata ka vlerësuar se dënimi i shqiptuar ndaj të pandehurit është në proporcion me veprën si dhe sjelljen e të pandehurit, dhe se dënimi i shqiptuar është adekuat me intensitetin e rrezikimit te vlerave te mbrojtura, personalitetin e te pandehurit, andaj

edhe konsideron se ky dënim do të ndikojë pozitivisht tek i pandehuri dhe personat tjerë që të mos kryejnë vepra të tilla penale dhe se me këtë do të arrihet në tërësi qëllimi i dënimit, i paraparë në nenin 38 të KPRK-së.

Vendimi për shpenzimet e procedurës është i bazuar në dispozitën e nenit 449 të KPP-së.

Vendimi për taksën në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimit është marrë konform nenit 36 par.3 nenpar.3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi për kërkesën pasurore juridike, është i bazuar në dispozitën e nenit 462 par.2 të KPP-së.

Bazuar në të lartecukurat u vendos si në dispozitiv të këtij urdhri ndëshkimor.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ
DEGA NË KAÇANIK
2024:216933 date 07.08.2024

Sekretarja Juridike
Indira Beqa

Gjyqtarja,
Zajrete Muhaxheri

Këshilla juridike, Kundër këtij Urdhri ndëshkimor i pandehuri mund të paraqet kundërshtim në këtë gjykatë në afat prej 8 ditësh nga dita e pranimit, në të kundërtën urdhri ndëshkimor merr formën e prere dhe është i ekzekutueshëm.